

Namazi Gjatë Muajit të Ramazanit dhe Nata e Kadrit

Disa nga udhëzimet dhe vlerësimet e shumta rreth namazit në muajin e lavdishëm të Ramazanit, janë dokumentuar nga dijetari el-Kaf'ami në vëllimin e dytë të veprës së tij *el-Misbah*.

Në faqet 657-660, ai përcjell nga libri i el-Shehidit mbi dyzet hadithet, që e citon Pejgamberin e Bekuar (s) duke thënë se ai që fal njëzet e pesë rekate në natën e parë të Ramazanit do të marrë shpërblimet e të gjithë atyre që ishin të parët në dëshmimin e vërtetësisë së të dërguarve të Allahut dhe atyre që flijuan jetët në rrugën e Tij; për më tepër, të gjitha mëkatet e tij do të falen dhe në Ditën e Gjykimit ai do të jetë me fitimtarët.

Atij që fal namaz gjatë natës së dytë, duke e përsëritur Fatihanë katër herë dhe Suren Kadr njëzet herë do t'i falen gjynahet dhe do t'i rritet riziku, dhe ai do të konsiderohet prej atyre që kanë ndjekur traditën (*Sunneh*) e Profetit (s).

Atij që fal namaz gjatë natës së tretë, duke e përsëritur Fatihanë dhjetë herë dhe Suren el-Ihlasë pesëdhjetë herë do t'i thuhet në Ditën e Gjykimit se Allahu e ka larguar nga zjarri dhe do t'i hapen shtatë porta të Xhennetit. Atij që e kalon natën duke falur namaze vullnetare (*nafile*) do t'i falen të gjitha mëkatet.

Atij që fal namaz gjatë natës së katërt, duke recituar Suren Fatiha një herë dhe Suren Kadr njëzet herë, do t'i paraqiten veprat përpara Allahut bashkë me ato të profetëve të Tij.

Atij që fal dy rekate gjatë natës së pestë, ku në secilin këndon Suren Fatiha një herë dhe Suren el-Ihlasë pesëdhjetë herë dhe i dërgon salavat Pejgamberit (s) njëqind herë, do të jetë përkrah Profetit (s) kur të hyjë në Xhennet.

Ai që fal namaz natën e gjashtë, duke recituar Suren Fatiha katër herë dhe Suren Tabarek njëherë do të konsiderohet sikur ta kishte bërë këtë në Natën e Kadrit (*Lejletu'l-kadr*).

Atij që fal namaz gjatë natës së shtatë, duke recituar Suren Fatiha një herë dhe Suren Kadr trembëdhjetë herë, Allahu do t'i ndërtojë në Xhennet një pallat prej ari dhe ai do të jetë i mbrojtur nga zemërimi i Tij deri vitin tjetër.

Atij që fal dy rekate namaz gjatë natës së tetë, duke recituar Suren el-Fatiha një herë dhe Suren el-Ihlasë njëmbëdhjetë herë, e pastaj i dërgon salavate Profetit të Bekuar (s) dhe e lavdëron Allahun njëmijë herë, do t'i hapen dyert e Xhennetit për të hyrë nga cilado prej tyre t'i pëlqejë.

Atij që fal namaz natën e nëntë duke recituar, nga akshami e deri në mbrëmje Fatihanë një herë dhe ajetin kursi shtatë herë, duke i dërguar salavate Pejgamberit të Bekuar (s) pesëdhjetë herë, veprat e tij do të ngrihen në nivelin e siddikëve, shehidëve dhe salihinëve.

Atij që fal njëzet rekate namaz natën e dhjetë, duke recituar në secilin Suren Fatiha një herë dhe Suren Teuhid (Ihlasë) tridhjetë e një herë, Allahu do t'ia zgjerojë rrizkun dhe ai do të jetë me fitimtarët në Ditën e Gjykimit.

Atij që fal dy rekate namaz gjatë natës së njëmbëdhjetë, duke kënduar Suren el-Fatiha një herë dhe Suren el-Keuther njëzet herë, Allahu do t'ia falë të gjitha mëkatet në atë ditë.

Atij që fal tetë rekate namaz natën e dymbëdhjetë, duke recituar në secilin Suren el-Fatiha një herë dhe Suren Kadr tridhjetë herë, do t'i jepen shpërblimet e atyre që e kanë falënderuar Allahun siç duhet falënderuar, dhe ai do të konsiderohet me ngulmuesit e duruar [në vështirësi] në Ditën e Gjykimit.

Ai që fal katër rekate namaz natën e trembëdhjetë, duke recituar Suren el-Fatiha një herë dhe el-Ihlasë njëzet e pesë herë, do të kalojë përmbi Sirat aq shpejt sa rufeja.

Atij që fal gjashtë rekate namaz natën e katërbëdhjetë, duke recituar në secilën Fatihanë një herë dhe Suren Zelzele tridhjetë herë, Allahu do t'ia bëjë kohën e vdekjes dhe [llogaridhënien ndaj] Munkirit e Nakirit të lehtë.

Atij që fal katër rekate natën e pesëmbëdhjetë, duke recituar pas Fatihasë në dy të parët Suren Ihlasë njëqind herë dhe pas Fatihasë në dy rekatet e fundit Suren Ihlasë pesëdhjetë herë, do t'i dhurohet ajo që vetëm Allahu e di.

Ai që fal dymbëdhjetë rekate namaz në natën e gjashtëmbëdhjetë, duke recituar Fatihanë një herë dhe Suren Tekathur dymbëdhjetë herë do të ngrihet nga varri etjeshuar, duke përsëritur shehadetin gjersa të arrijë në Xhennet, ku do të hyjë pa u pyetur.

Atij që fal dy rekate namaz në natën e shtatëmbëdhjetë, duke recituar në të parin Suren Fatiha dhe një tjetër, kurse në të dytin Suren Fatiha një herë dhe Suren Ihlasë njëqind herë, duke i dërguar më pas salavate Pejgamberit të Bekuar (s) dhe dëshmuar për Njëshmërinë e Allahut (me *la il-lahe ila'Llah*), do t'i jepen shpërblimet e kryerjes së haxhit njëmijë herë, të umres njëmijë herë dhe të ghazves (fushatave ushtarake) njëmijë herë.

Atij që fal katër rekate namaz natën e tetëmbëdhjetë, duke recituar pas Fatihasë Suren Keuther njëzet e pesë herë, meleku i vdekjes do t'i sjellë sihariqin se Allahu është i kënaqur me të.

Ai që fal pesëdhjetë rekate namaz natën e nëntëmbëdhjetë, duke recituar suren Fatiha një herë dhe suren Zelzele pesëdhjetë herë në secilin, do të konsiderohet si ta kishte kryer haxhë dhe 'umren njëqind herë, dhe Allahu do t'ia pranojë të gjitha veprat e mira.

Atij që fal tetë rekate namaz në natën e njëzetë, duke recituar nga suret e Kur'anit ç'të dëshirojë, do t'ia falën gjynahet.

Atij që fal tetë rekate namaz natën e njëzetënjëtë, duke recituar ç'të dëshirojë ai vetë nga Ku'rani, do t'i hapen dyert e Xhennetit dhe do t'i plotësohet lutja, e ai do të ketë edhe më tepër shpërblime nga Allahu.

Ai që fal tetë rekate natën e njëzetedytë, duke recituar ç'të dëshirojë nga Kur'ani, do të konsiderohet si ai që ka kryer edhe haxhxin edhe 'umren.

Atij që fal tetë rekate natën e njëzetepestë, duke recituar në secilin Fatihanë një herë dhe Suren Ihlasë dhjetë herë, Allahu do t'i dhurojë shpërblimet e të përzotshmëve.

Ai që fal katër rekate natën e njëzeteshtatë të Ramazanit, duke recituar në çdonjërin Suren Fatiha dhe Suren Tabarak (e nësë nuk e di këtë le të recitojë Fatihanë njëzet e pesë herë), do të falet [nga Allahu] bashkë me prindërit e tij.

Ai që fal gjashtë rekate natën e njëzetetëtë, duke recituar Fatihanë një herë dhe Suret el-Kursi, el-Keuther dhe et-Teuhid dhjetë herë, e i dërgon më pas njëqind salavate Pejgamberit të Dashur (s), do të falet patjetër [nga Allahu].

Ai që fal dy rekate namaz në natën e njëzetënjëtë, duke recituar pas Fatihasë Suren Teuhid njëzet herë, do të mëshirohet dhe libri i tij i veprave do të ngjitet në 'ilijinë.

Atij që fal dymbëdhjetë rekate natën e tridhjetë, duke recituar Fatihanë një herë dhe Suren Ihlasë [Teuhid] njëzet herë, do t'i vulosen veprat me mëshirë nga Allahu, pasi t'i ketë dërguar salavate Pejgamberit Fisnik njëqind herë.

Marrja e ghusl-it

Lejletu'l-Kadri është njëra nga dhjetë netët e fundit të muajit të Ramazanit. Në vëllimin X, faqe 94 të veprës së tij *Biharu'l-Enuar*, 'Alame Mexhlisiu citon Imam 'Aliun duke thënë për të: "Kërkojeni në dhjetë ditët e fundit, sepse mash'aret janë shtatë, po kështu edhe qiejt, dhe tokat, dhe shtatë lopët e shtatë kallinjë." Imami citohet gjithashtu duke thënë se gjatë atyre ditëve i Dërguari i Allahut (s.a.) e kishte zakon ta mblidhte dyshekun, ta lidhte gilabijen dhe ta mbante familjen zgjuar, sidomos gjatë natës së 23-të, duke u hedhur pika uji në fytyrë atyre që kishin shenja gjumi. Fatime Zehraja e kishte zakon të mos i lejonte askujt në shtëpinë e saj të flinte, duke u dhënë atyre fare pak ushqim [për të mos u rënduar] dhe madje bëhej gati për të edhe ditën. Ajo e kishte zakon të thoshte: "Kush privohet prej mirësisë së saj, vërtet, pëson privimin më të madh." Prandaj, është shumë e këshillueshme të merret *ghusl* (banjë rituale) sidomos gjatë dhjetë ditëve të fundit të muajit të Ramazanit. Sipas veprës *el-Ikbal*, Imam Sadiku citohet duke thënë se i Dërguari i Allahut (s) e kishte zakon të merrte *ghusl* çdo natë në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit.

Nata e Kadrit

Në vëllimin III, faqe 265 e veprës *Muftahu'l-Xhennat* të el-Eminit, i Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë: "Allahu e ka pëlqyer Xhumanë mbi ditët e tjera, muajin e Ramazanit mbi të gjithë muajt e tjerë dhe Natën e Kadrit mbi të gjitha netët." Dhe

Allahu e ka pëlqyer Kur'anin e Shenjtë përmbi të gjithë Librat e tjerë që ka shpallur. Ibrahim, njëri nga nxënësit e Imam Sadikut, citohet në faqen 95 të vëllimit XCIV të veprës *Bihar ul-Enuar*, duke thënë se ai e pyeti një herë Imamin se si ishte zbritur Kur'ani Fisnik në Natën e Kadrit, kur dihej se ishin dashur njëzet e tre vjet që të shpallej. Imami i ishte përgjigjur: “Kur'ani Fisnik u zbrit i tëri në muajin e Ramazanit, tek Shtëpia e lashtë (Qa'bja), dhe së andejmi u shpall për njëzet e tre vjet.” Pastaj, Imami citoi fjalët e të Dërguarit të Allahut (s): “Fletushkat e Ibrahimit ('a) janë shpallur natën e parë të Ramazanit; Teurati është shpallur me gjashtë Ramazan; Inxhili me trembëdhjetë; Zeburi më tetëmbëdhjetë Ramazan, kurse Kur'ani i Shenjtë me 24 Ramazan.” Ky hadith përcillet edhe në faqe 80 të vëllimit I të *Tefsir*-it të el-'Ajjashit.

Kjo natë e ka marrë emrin e Kadrit sepse në të Allahu i përcakton secilit se ç' do t'i ndodhë gjatë vitit në vazhdim. 'Kadr' në këtë kuptim do të thotë 'fat'. Sipas shpjegimit në faqen 432 të vëllimit II në *Tefsir*-in e Kummiut, një caktim i tillë i fatit përfshin jetën dhe vdekjen, rrizkun, bollëkun e ta lashtave ose urinë, dhe çdo të mirë a të keqe. Kjo nënkupton që Allahu i Lartmadhëruar cakton në këtë natë çdo ngjarje që do t'i ndodhë cilësdos krijesë të Tij gjatë vitit.

Në faqen 94 të vëllimit XII të veprës së tij *Bihar ul-Enuar*, 'Alame Mexhlisiu citon të atin duke transmetuar nga en-Naderi që përcjell nga Jahja el-Halebi i cili citon nga Ibn Maskani se Imam Sadiku ka thënë: “Gjatë Lejletu'l-Kadrit, melekët, Shpirti dhe shkruesit besnikë zbresin të gjithë në qiejt e ulët dhe shkruajnë ç'të ketë urdhëruar Allahu atë vit, e nëse Allahu dëshiron të shpejtojë diçka ose ta shtyjë apo të shtojë gjësend, Ai e urdhëron melekun ta fshijë dhe ta zëvendësojë me çfarë do Ai.” Kjo konfirmohet nga el-Kummi në *Tefsir*-in e tij të njohur. Në vëllimin I, faqe 182 të veprës '*Ujun Akhbar er-Rida* të Shejh es-Sadikut dhe në *Bihar ul-Enuar* të 'Alame Mexhlisiut, Xha'fer ibn 'Ali ibn Ahmed citon Hasan ibn Muhammed ibn 'Ali ibn Sadakanë që përcjell nga Muhammed ibn 'Abdul-'Azizi që transmeton nga Sulejman el-Marzavi se ky e pyeti Imam Ridain: “A mund të na tregosh se kur u shpall Sureja el-Kadr?” Imami iu përgjigj: “O Sulejman! Lejletu'l-Kadri është Nata kur Allahu, Më i Larti, Më i Madhi, urdhëron çfarë do të ndodhë nga njëri vit në tjetrin: me jetë ose vdekje, të mirë ose të keqe, ose lidhur me rrizkun – dhe çfarëdo që Ai të urdhërojë është kader i sigurtë...”

Në faqe 315 të veprës *Me'ani ul-Akhbar* si dhe në faqe 18 të vëllimit XCIV të *Bihar ul-Enuarit*, Ibn Musa citon Ibn Zekerijjanë që transmeton nga Muhammed ibn el-'Abbasi duke përcjellë nga Ahmed ibn 'Abdullah ibn Junusi që tregon se Ibn Tarifi transmeton nga Asbagh ibn Nabate se Imam 'Aliu ka thënë: “I Dërguari i Allahut (s) më pyeti një herë: ‘O 'Ali! A e di domethënien e Leiletu'l-Kadrit?’ e unë i thashë: ‘Jo, o i Dërguari i Allahut.’ Ai më tha: ‘Allahu, i Lavdëruari e i Madhëruari ka dekretuar në të se çfarë do të ndodhë deri në Ditën e Kijametit dhe nga ato që Ai, Më i Larti e Më i Madhi, ka dekretuar është Imameti dhe vilajeti yt e i pasardhësve tuaj deri në Ditën e Gjykimit.’”

Të dyja veprat e mësipërme transmetojnë nga Sa'di, që citon 'Abdullah ibn 'Umer ibn el-Khattabin duke përcjellë nga Muhammed ibn 'Ubejd ibn Mahrani që transmeton nga Salihu që citon Salih ibn 'Ukben i cili tregon se Fadl ibn 'Uthmani ka thënë: “Kur përmendën Suren el-Kadr në prani të Imam Ebu 'Abdullah Xha'fer es-Sadikut, atij iu kërkua të tregonte meritat e saj përmbi suret e tjera dhe ai tha: ‘Ajo u shpall në lidhje me Vilajetin e Prijësit të Besimtarëve.’ E pyetën: ‘E ke fjalën për Lejletu'l-Kadrin që

presim me padurim gjatë muajit të Ramazanit?’ Ai u përgjigj: ‘Po; ajo është nata në të cilën qiejt dhe toka u përcaktuan, dhe Vilajeti i Prijësit të Besimtarëve u dekretua.’”

Sikurse citohet në faqe 21 të vëllimit XCIV të veprës *Bihar ul-Enuar*, Ahmed ibn Muhammedi dhe Ahmed ibn Is’haku përcjellin nga el-Kasim ibn Jahjai që transmeton nga njerëz të tjerë se Imam Sadiku ka treguar se Imam ‘Aliu thoshte shpesh: “E pamë të Dërguarin e Allahut (s) njëherë me et-Tejmiun dhe një mik të tij, teksa ky po këndonte Suren el-Kadr. Ai (s.a.) u prek thellësisht dhe vazhdoi të qante gjersa i thanë: ‘Sa shumë t’u prek zemra nga kjo sure, o i Dërguari i Allahut!’ Ai u përgjigj: ‘Zemra m’u prek shumë prej asaj që më panë sytë e rroku mendja, dhe prej asaj që do të kalojë zemra e këtij njeriu [‘Aliut] pas meje.’ Të dy e pyetën të Dërguarin e Allahut (s): ‘Vërtet i pe ato të gjitha?! Po ‘Aliu çfarë do shohë?’ Pastaj ai recitoi ajetin {Engjëjt dhe Shpirti zbresin në të me lejen e Zotit të tyre për çdo çështje; paqe, deri në agim}. Pastaj ai pushoi ca dhe i pyeti: ‘A mbetet ndonjë gjë [pa u përcaktuar] kur Allahu ka thënë {çdo çështje}?’ Ata mohuan që të dy dhe atëherë ai i pyeti: ‘A e dini se për kë është zbritur?’ Kur ata u përgjigjën: ‘jo, për Allah, o i Dërguari i Zotit’, ai u tha: ‘Vërtet, a do ketë Lejletu’l-Kadr pas meje?’ Ata pohuan dhe atëherë ai i pyeti: ‘A do të zbresë çdo çështje në të?’ Ata thanë: ‘Po’, me ç’rast ai i pyeti: ‘Kujt do t’i zbresë?’ Ata u përgjigjën: ‘nuk e dimë.’ Atëherë, ai (s.a.) duke vënë dorën e tij mbi kokën time, më shtyu lehtë përpara dhe tha: ‘Nëse nuk e dini, bëhet fjalë për këtë njeri pas meje.’ Që nga kalimi i Pejgamberit (s), të dy ata burra mbusheshin me mahnitje saherë që afrohej ajo natë.”

Fuqiploti thotë se: {Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë} (44:4), çka nënkupton se në këtë natë, Më i Lartësuar i urdhëron gjithçka që do të ndodhë vitin e ardhshëm. Në arabisht gjithahtu thuhet se dikush ka ‘kadr’, pra pozitë dhe prestigj shoqëror që ai e gëzon ndër njerëz. Në këtë kuptim, ‘kadr’ tregon prestigj dhe rëndësi. Dhe i Plotfuqishmi thotë gjithashtu në Kur’an {Ata nuk e madhëruan Allahun me madhështinë që i takon} (6:91, 22:74, 39:67) pra ‘kadr’ në këtë ajet nënkupton madhërim. Atëherë, Lejletu’l-Kadri është nata e madhe që gëzon prestigj dhe vlerësim të madh tek Allahu dhe në të cilën Ai përcakton e vendos fatin dhe furnizimin e tërë krijimit. Ajo ka pozitë të veçantë sepse bindja ndaj Allahut gjatë saj këshillohet me seriozitet e nxitje të madhe, ku një shpërblim i madh i pret ata që e nderojnë muajin në të cilin ajo bie.

Tregohet gjithashtu se ajo u emërua kështu sepse një Libër nga Allahu që gëzon madhësi pozitive iu shpall Profetit të Bekuar (s), i cili po ashtu gëzon nderim dhe prestigj të lartë. Një pikëpamje tjetër është se ajo u quajt kështu sepse toka drejtohet për shkak të numrit të engjëjve mbi të. Sipas këtij këndvështrimi, ‘kadr’ mbart kuptimin e drejtshmërisë, për shkak të faktit se Allahu i Madhëruar ka thënë: {... dhe kujt do që Ai vendos t’ia drejtojë furnizimin...}, ua’Llalu a’lem.

Allahu i është drejtuar robit dhe të Dërguarit të Vet, zotëriut tonë, Muhammedit (s) me fjalët: {E ç’të bëri ty të kuptosh se çfarë është Lejletu’l-Kadri? Lejletu’l-Kadri është më e mirë se njëmijë muaj} pra ‘si mund ta dish madhështinë, rëndësinë dhe shenjtërinë e kësaj nate, që e kam bërë më të mirë se njëmijë muaj?’

Këta janë tregues që Kur’ani i Shenjtë i është shpallur në tërësi të Dërguarit Besnik (s). Në Suren 44 të Kur’anit Fisnik lexojmë: {Ha, Mimë. Pasha Librin që shpalos (të

Vërtetën), vërtet Ne e shpallëm atë në një Natë të bekuar} (1-3) dhe {Pa dyshim, Ne e shpallëm në Natën e Kadrit} (98:1).

Ibn 'Abbasi citohet duke thënë se: “Kur’ani Fisnik u shpall si tërësi nga Lavh-i Mahfudhë, prej qiejve e në tokën e ulët gjatë Natës së Kadrit, pastaj Xhibra’ili e kishte zakon t’ia shpallte Muhammedit (s) gradualisht.” Dihet mirë se Kur’ani iu zbrit Profetit të Bekuar (s) me pjesë në një periudhë njëzet e tre vjeçare. Sureja e parë që iu shpall të Dërguarit të Allahut (s) në Shpellën e Hirasë ishte el-‘Alak, kur Xhibra’ili i tha: “Lexo!” Ai u përgjigj: “Nuk mund të lexoj.” Ai përsëriti: “Lexo!” dhe Pejgamberi (s.a.) tha prapë: “Nuk mund të lexoj.” Atëherë, Xhibra’ili i tha: {Lexo, në Emër të Zotit tënd, që krijoi...} (96:1) deri në fund të Sures. Ajeti i fundit i Librit të Lavdishëm të Allahut që iu shpall Profetit (s) ishte: {Sot përsosa fenë tuaj për ju dhe i plotësova favoret e Mia ndaj jush e zgjedha për ju si fe ISLAMIN} (5:3). Kështu, kësaj nate i mjafton nderi dhe dinjiteti që është zgjedhur nga i Lartmadhëruari për të shpallur në të Kur’anin e Lavdishëm, që është drita shkëlqyese dhe udhëzuese e Islamit dhe kushtetuta e ndjekësve të tij.

Përse është Lejletu’l-Kadri më i mirë se njëmijë muaj? Përse nuk është dhjetë mijë ose njëqind mijë? Në faqe 432 të vëllimit II të *Tefsir*-it të tij, el-Kummi tregon se i Dërguari i Allahut (s) pa njëherë në ëndërr disa majmunë tek ngjiteshin në minberin e tij dhe u mërzit së tepërmi; atëherë Sureja el-Kadr iu zbrit për t’ia larguar pikëllimin. Vërejmë se periudha e sundimit të umejjadëve zgjati afërsisht njëmijë muaj: nga viti 661 deri më 750. Si el-Kulejni në përmbledhjen e tij *el-Kafi*, ashtu edhe ‘Alame Mexhliu në *Bihar ul-Enuar* citojnë Ahmed ibn Muhammedin duke përcjellë nga ‘Ali ibn el-Hasani, që transmeton nga Muhammed ibn el-Uelidi dhe Muhammed ibn Ahmedi, që citojnë Junus ibn Ja’kubin i cili përcjell nga ‘Ali ibn ‘Isa el-Kammati që tregon nga xhaxhai i tij se Imam Ebu Abdullah Xha’fer es-Sadiku ka thënë: “Të Dërguarit të Allahut (s) iu tregua në ëndërr se si Beni Umejja ngjiteshin mbi minberin e tij (si majmunët mbi pemë), dhe ai u mërzit shumë, me ç’rast Xhibra’ili (‘a) erdhi tek ai dhe e pyeti përse ishte aq i mërzitur. Ai iu përgjigj: ‘Kam parë sonte Beni Ummejet tek ngjiteshin në minberin tim, pasi që i kishin shmangur njerëzit nga Rruga e Drejtë.’ Xhibra’ili (‘a) i tha: ‘Betohem me Atë që më ka nisur me të Vërtetën, kjo është diçka për të cilën nuk di gjë’ dhe u ngjit në qiej. Pas pak, ai i sollli Pejgamberit (s.a.) një ajet për t’ia larguar brengën: {A e ke parë se edhe nëse Ne u japim të shijojnë vite me rradhë, e pastaj t’u vijë atyre ajo me çka u tërhiqet vërejtja, çka do t’u vlejë ajo që gëzuan?} (26:205-207). Dhe ai gjithashtu i sollli: {Ne e shpallëm atë në Lejletu’l-Kadr, e si mund ta dish ti se ç’është Lejletu’l-Kadr? Lejletu’l-Kadr është më e mirë se njëmijë muaj...}

Lejletu’l-Kadri është natë e bekuar edhe për arsyen se Fuqiploti zbret gjatë saj mirësi, begati dhe falje për shërbëtorët e Vet. Një hadith profetik tregon se kur afrohet Lejletu’l-Kadri, Allahu i Madhërishëm e urdhëron Xhibra’ilin (‘a) të zbresë në tokë, i shoqëruar me një tufë melekësh, me një flamur të gjelbër. Ai e hedh flamurin përmbi Qa’be me gjashtëqind krahët e tij, njëri nga të cilët nuk hapet kurrë veçse gjatë Natës së Kadrit; ndaj, ai i hap krahët në atë natë dhe bashkë me të gjithë melekët përshëndet këdo që ngrihet në namaz, rri ulur, adhuron apo lexon Kur’an. Pastaj, ai shtrëngon duart me ta dhe i përgjërohet Allahut t’ua pranojë atyre lutjet, e ata vazhdojnë kështu deri në agim. Atëherë, ata e pyesin Xhibra’ilin: “Ç’ka bërë Allahu i Madhërishëm me dëshirat e besimtarëve nga ummeti i Muhammedit (s)?” e ai u përgjigjet: “Allahu i Madhërishëm e

ka hedhur vështrimin e Tij mbi ta në këtë natë dhe i ka falur; që të gjithë, përveç atij që është i dhënë pas pijes, atij që ndërpret lidhjet me farefisën dhe atij që përhap sherre.”

Allahu Fuqplotë ka thënë: {Leiletu'l-Kadri është më e mirë se njëmijë muaj} që matematikisht mund të nënkuptojë se ajo natë, që është veçse disa orë, nderohet dhe lavdërohet nga Allahu përmbi tetëdhjetë e tre vjet, që janë afërsisht të barazvlefshëm me njëmijë muaj. Umejjadët e luftuan Islamin që nga ngjizja e tij, pastaj luftuan Ehl-i Bejtin e Profetit (s) gjatë gjithë kohës që ishin në pushtet. Sunduesi i parë i vetëdeklaruar umejjad ishte Mu'avije ibn Ebu Sufjani, kurse i fundit Mu'avije ibn el-Himari dhe kjo periudhë kohe është sa njëmijë muaj. Është tamam sikur Kur'ani i Shenjtë të thotë se një natë në sytë e Allahut është më e mirë se të njëmijë muajt që umejjadët e prishur sunduan mbi muslimanët me forcë.

Allahu Fuqplotë ka thënë gjithashtu: {Paqe, gjer në agim} pra, “Lejletu'l-Kadri është një natë paqeje dhe qetësie ndaj çdo ligësie, ngacmimi dhe keqbërjeje të djajve. Gjatë saj nuk mund të ndodhë asnjë ligësi, dhe asnjë shejtan nuk mund ta ushtrojë hilen e tij. Ajo është paqe për të devotshmit që përshëndeten saherë që takohen me engjëjt. Melekët i përshëndesin ata dhe ty, o Muhammed, e po kështu dhe Shpirti, që nga çasti i zbritjes nga qiejt e deri në agim.”

Sipas librit *el-Ikbal*, që citon veprën *Kenz ul-Javvakit* nga Ebu'l-Fadl ibn Muhammed el-Harvi, Pejgamberi Fisnik (s) ka thënë: “Kujt qëndron zgjuar gjatë Natës së Kadrit në adhurim, do t'i shtyhet dënimi gjer vitin tjetër.” Sipas po kësaj reference, Profeti (s.a.) tregon se Musai ('a) iu drejtua një herë Allahut Fuqplotë, me fjalët: “O Zot! Dëshiroj të jem pranë Teje.” Zoti i tha: “Ai që dëshiron të jetë pranë Meje është ai që rri zgjuar gjatë Natës së Kadrit [në adhurim].” Ai ('a) tha: “O Zot! Dua të fitoj mëshirën Tënde.” Fuqploti i tha: “Mëshira Ime i derdhet mbi atë që është bamirës me të skamurit gjatë Lejletu'l-Kadrit.” Ai ('a) tha: “O Zot! Dua të vazhdoj në rrugë të drejtë.” Allahu iu përgjigj: “Kjo i dhurohet atij që jep lëmoshë gjatë Lejletu'l-Kadrit.” Ai ('a) tha: “O Zot! Dëshiroj të shijoj pemët dhe frutat e Xhennetit.” Allahu iu përgjigj: “Kjo i jepet atij që Më lavdëron gjatë Lejletu'l-Kadrit.” Ai ('a) tha: “O Zot! Dëshiroj shpëtimin nga Zjarri.” I Madhërishtë iu përgjigj: “Ky i dhurohet atij që kërkon falje gjatë Lejletu'l-Kadrit.” Musai ('a) vazhdoi duke thënë: “O Zot! Dua të arrij kënaqësinë Tënde.” Allahu i tha: “Do të kënaqem me cilindo që fal dy rekate gjatë Lejletu'l-Kadrit.”

Po aty, i Dërguari i Allahut (s) citohet duke thënë se portat e qiellit do të hapen gjatë Lejletu'l-Kadrit; çdo besimtar që falet gjatë saj do të marrë një pemë në Xhennet për çdo sexhde që bën, nën të cilën kalorësi mund të udhëtojë për njëqind vjet pa ia përshkuar hijen tej për tej. Dhe për çdo rekat ai do të marrë një pallat në Xhennet me perla, xhevahirë, safirë dhe diamante. Për çdo ajet që reciton do të marrë një nga kurorat e Parajsës...etj. Hadithi është i gjatë dhe flet për shpërblime të mëdha.

Në veprën e tij *Kitab ul-Husna*, el-Durijasti citon nga Imam Xhevadi i cili përcjell nga paraardhësit e vet se Imam Bakiri ka treguar që i Dërguari i Allahut (s) ka thënë se personit që e kalon Lejletu'l-Kadrit duke adhuruar Zotin e vet, do t'i falen të gjitha mëkatet edhe sikur të jenë sa yjet në qiell, të peshojnë sa malet e të zënë vëllimin e tërë detërave. El-Harvi e transmeton gjithashtu një hadith të ngjashëm, që regjistrohet në *Kenz ul-Jevakit*.

Ibn ‘Abbasi r.a. citohet në faqe 5351 të *es-Sahih el-Xhami* duke treguar se i Dërguari i Allahut (s) ka thënë: “Lejletu’l-Kadri është e lehtë, me fllad, as shumë e ngrohtë as shumë e ftohtë; dielli ngrihet në mëngjesin e saj i kuq i zbehtë.” I Dërguari i Allahut (s) citohet gjithashtu duke thënë: “Në mëngjesin e Natës së Kadrit, dielli lind pa rreze, si enë, gjersa ngjitet lart.” Ky hadith transmetohet nga Muslimi dhe Tirmidhiu. Po ashtu, Pejgamberi (s.a.) citohet duke thënë se: “Lejletu’l-Kadri është një natë e qetë, as e nxehtë as e ftohtë, gjatë së cilës nuk hidhen kometa... Nga shenjat e ardhjes së saj është se dielli lind pa rreze.”

Në veprën *Zad ul-Ma’ad* citohen disa dijetarë që besojnë në vazhdimësinë e saj, ku disa pohojnë se ajo është në fund të vitit, të tjerë thonë se është në Sha’ban dhe në muajin e Ramazanit, dhe të tjerë akoma thonë se është nata e mesit në Sha’ban. Disa mendojnë se është në fillim të Ramazanit, disa në mes e të tjera akoma thonë se është më shtatëmbëdhjetë. Disa besojnë se është me 29, të tjerë thonë se është nata e fundit kurse shumica e sunnive bashkëkohës janë të mendimit se ajo është me 27. Kjo tregon edhe një herë që arsyeja pse ajo nuk u caktua saktësisht është që të vigjëlohet në tërë muajin.

Transmetohet gjithashtu se në Lejletu’l-Kadr ka ndodhur *isra*-ja dhe Allahu e ka ngritur Isain, të birin e Merjemes tek Vetja. Në të ka vdekur edhe profeti Musa (‘a) si dhe Jusha ibn Nuni, uasiu i Musait (‘a). Dhe në këtë natë është bërë shehid Prijësi i Besimtarëve.

Mbështetur në autoritetin e Imam Bakirit, disa transmetues kanë treguar se Pejgamberi (s) u pyet njëherë për Lejletu’l-Kadrin dhe tha: “Keni pyetur për Lejletu’l-Kadrin. Unë s’jua kam fshehur dijeninë për të nga padija ime rreth saj. Ta dini, o njerëz, se ai që është i shendetshëm në Ramazan, agjëron në ditët e tij dhe falet gjatë një pjese të netëve të tij dhe është i përpiktë në namazet e detyrueshme, përpiket të ndjekë xhumatë gjatë tij dhe namazin e Bajramit më pas, ai do ta ketë respektuar Natën e Kadrit siç duhet dhe do të ketë shpërblimin e tij nga Krijuesi.”

Në *Thevab ul-A’mal* dhe *Bihar ul-Enuar* citohet Ibn el-Muteuakkili që transmeton nga Muhammed el-Attari i cili përcjell nga el-Esh’ariu që citon Muhammed ibn Hasani që transmeton nga Ibn Mahrani se el-Bataini përcjell nga i ati se Ebu Busejri tregon që Imam Sadiku ka thënë se: ai që e reciton Suren Ankebutë dhe Suren Rumë në natën e njëzet e tretë të Ramazanit do ta garantojë hyrjen në Xhennet. Në faqen 19 të vëllimit XCIV të veprës *Bihar ul-Enuar*, Imami citohet të ketë thënë: “Nuk frikësohem që Allahu të më shkruajë një gjynah pse e thashë këtë, pasi vërtet, këto dy sure gëzojnë pozitë të lartë tek Allahu.”

Cila natë është Lejletu’l-Kadri?

A është e 17-a apo e 19-a? Imam Ebu Xha’fer Muhammed ibn ‘Ali el-Bakir citohet në *Bihar ul-Enuar* dhe *Da’aim ul-Islam* se ka thënë: “Nata e shtatëmbëdhjetë e Ramazanit është ajo kur dy palët u takuan, kurse e nëntëmbëdhjeta është ajo kur shkruhet lista e haxhilerëve, e njëzetënjëta është ajo në të cilën zëvendësit e Profetëve kanë ndërruar jetë, Isai është ngritur në qiell dhe Musai ndërroi jetë, kurse e njëzetetreta shpresohet të jetë Nata e Kadrit.”

Edhe *Tefsir*-i i 'Ajjashiut edhe *Bihar ul-Enuari* i 'Alame Mexhlisiut citojnë 'Amr ibn Sa'idin duke thënë: "Një medinas nuk pajtohej me mua lidhur me Natën (e Kadrit) kur janë takuar dy palët, duke thënë se ajo ishte e shtatëmbëdhjeta e Ramazanit, ndaj shkova të takoj Ebu 'Abdullahun (Imam Xha'fer es-Sadikun) e i tregova për mospajtimin tonë, me ç'rast ai tha: 'Medinasi e ka gabim; unë e di se ti e ke fjalën që ajo është nata e nëntëmbëdhjetë, kur është plagosur Prijësi i Besimtarëve, që është e njëjta natë kur Isai i biri i Merjemes u ngjit në qiell."

Po këto referenca citojnë Humranin, që transmeton nga Imam Sadiku se: "Vendimi i përmendur në Lejletu'l-Kadr është i njëjti me atë që përmendet në një ajet tjetër, ku Më i Larti thotë: {... e kur t'u vijë afati tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë}." (7:34)

Apo është nata e 21-të ose e 23ta? Sipas veprës *Mexhalis el-Shejh*, që citohet në *Bihar ul-Enuar*, vëll. II, f. 94, Husein ibn 'Ubejdullahu citon Ahmed ibn Muhammed ibn Jahjain i cili përcjell nga i ati se: "Isha në shoqërinë e Ebu 'Abdullahut [Imam Sadikut], kur Ebu Busejri e pyeti: 'Cila natë është ajo kur i duhet lutur Zotit çfarë të dëshirohet?' Imami iu përgjigj me fjalët: 'Ose e njëzetënjeta ose e njëzetetreta.' Unë e pyeta: 'Po sikur të mos kem fuqi t'i mbaj [dmth të rri zgjuar për adhurim]?' e Imami më tha: 'Sa e lehtë është t'i mbash, në krahasim me lutjet [dëshirat] tuaja!'"

Imam Sadiku citohet gjithashtu në po atë vëllim të veprës *Bihar ul-Enuar*, duke thënë: "Nata e njëzet e tretë e muajit të Ramazanit është ajo në të cilën vendoset çdo çështje me rëndësi, kur sprovat, fatkeqësitë, vdekjet dhe rrizku e çështje të tjera caktohen, e po kështu edhe ajo që dëshiron Allahu të ndodhë për krejt vitin në vazhdim; ndaj, përgëzime për atë që rri zgjuar në të duke rënë në sexhde, bërë ruku', menduar për mëkatet dhe qarë për të tizat – sepse po t'i bëni të gjitha këto, insha' Allah, nuk do të zhgënjeheni." Pastaj ai shtoi: "Allahu do ta urdhërojë një melek që të thërrasë në çdo natë e ditë të muajit të Ramazanit, për t'ua përcjellë atyre mesazhin e Allahut me këto fjalë: 'Sihariqe, o robërit e Mi! Jua kam falur gjynahet e shkuara dhe i kam lejuar disa prej jush të ndërmjetësojnë për të tjerët në Lejletu'l-Kadr, përveç atyre që e prishin agjërimin me ndonjë pije ose atyre që kanë mëri ndaj ndonjë vëllai musliman.'" Transmetohet po ashtu se Allahu Subhanehu ue Te'ala i largon të gjitha ligësitë, gjynahet dhe sprovat nga robërit e Tij agjërues natën e njëzetepestë dhe u jep dritë në dëgjim e shikim, ku Xhenneti zbukurohet gjatë Lejletu'l-Kadrit ditë e natë.

Dijetari i madh sunni Ibn Ebi'l-Hadid citon në komentarin e tij të *Nehxhul Belaghës*, veprën *Amali* të Ibn Durejdit, ku tregohet se el-Xharmudhi citon Ibn el-Muhalebiun nga Ibn el-Kalbi që transmeton nga Shaddad ibn Ibrahim i cili sjell nga 'Ubejdullah ibn el-Hasan el-Fahri, që citon Ibn 'Araden duke thënë: "Prijësin e Besimtarëve e pyetën njëherë për Lejletu'l-Kadrin dhe ai tha: 'Nuk është pa gjasa që unë ta di se kur është ajo dhe ta fsheh me dashje një dije të tillë, e nuk kam asnjë dyshim që Allahu jua ka fshehur një dije të tillë nga dashuria e Tij për ju, se po ta dinit cila natë është ajo, do ta kishit nderuar atë dhe lënë pas dore të tjerat, ndaj shpresoj se nuk do gaboni në këtë gjë.'" "

Vepra të Këshilluara për Secilën nga Dhjetë Netët e Fundit të Muajit

Ndër veprat e këshillueshme për këtë periudhë është edhe ajo që transmetohet nga Pejgamberi (s): “Atë që fal dy rekate në Lejletu’l-Kadr duke recituar Fatihanë një herë dhe Suren Ihlasë shtatë herë në secilin, dhe kërkon më pas shtatëdhjetë herë *istighfar* dhe shton ‘*estaghfirullah ue itubu ilejh*’ [kërkoj falje nga Zoti dhe Atij i pendohem], kur të ngrihet, Allahu do ta ketë falur bashkë me prindërit e tij dhe do t’i dërgojë engjëj t’ia regjistrojnë veprat e mira edhe për një vit, si dhe melekë që t’i mbjellin pemë në Xhennet e t’i ndërtojnë pallate dhe çelin burime, e ai nuk do ta lërë këtë botë pa e parë çfarë ka në Xhennet për të.”

Një tjetër veprim i këshillueshëm është *ghusli* (banja rituale) që rekomandohet shumë dhe theksohet sidomos në tre netët e fundit të muajit, ku koha më e mirë për ta kryer është pas faljes së akshamit. Është po ashtu e këshillueshme që të mos u afrohemi intimisht bashkëshorteve në këto dhjetë netë të fundit, por t’u qasemi atyre në 20 netët e para. Ç’është e vërteta, në faqe 180 të vëllimit IV të librit *el-Kafi* nga el-Kulejni, në faqe 348 të vëllimit XCIV të veprës *Bihar ul-Enuar* të ‘Alame Mexhlisiut dhe në faqe 112 të vëllimit II të veprës *Men la Jahduru’l-Fekih* tregojnë se është shumë e këshillueshme t’u afrohemi bashkëshorteve sidomos në netët e para të muajit të Ramazanit. Këta libra citojnë Prijësin e Besimtarëve duke thënë se është e këshillueshme që besimtari të hyjë në intimitet me bashkëshorten sidomos natën e parë të këtij muaji të shenjtë.

Një tjetër veprim i këshillueshëm është i ashtuquajtur ‘përgjërimit për hir të shenjtërisë së Kur’anit Kerim’, që transmetohet nga Imam Bakiri dhe Imam Sadiku, të cilët kanë thënë: “Duhet ta merrni Kur’anin Kerim gjatë tre netëve të fundit të muajit të Ramazanit, ta hapni, ta vendosni në duar e të thoni: ‘O Zot! Të përgjërohëm me Librin Tënd të shpallur dhe gjithçka në të, se në të është Emri Yt i Madh dhe cilësitë më sublime. Të përgjërohëm që t’i dërgosh bekime Muhammedit dhe pasardhjes së Muhammedit e të më lirosh nga flakët e zjarrit’ pastaj shtrojani kërkesën tuaj Allahut.” Imam Sadiku citohet gjithashtu duke thënë: “Merreni Kur’anin Fisnik, vendoseni mbi kokë dhe thoni: ‘O Zot! Për mirësinë e këtij Kur’ani Kerim dhe atij të cilit ia shpalle, të çdo besimtari që ke përmendur në të dhe të drejtën Tënde, sepse askush nuk e din hakun tënd më mirë se Ti!’, pastaj përsëritni dhjetë herë: ‘Pasha mirësinë Tënde, o Zot i Madhërishtëm! Pasha Muhammedin, ‘Aliun, Fatimen, Hasanin, Huseinin, ‘Ali ibn Huseinin, Muhammed ibn ‘Aliun, Xha’fer ibn Muhammedin, Musa ibn Xha’ferin, ‘Ali ibn Musain, Muhammed ibn ‘Aliun, ‘Ali ibn Muhammedin, Hasan ibn ‘Aliun dhe Huxhxhetin (Mehdiun)’ pastaj thoni kërkesën tuaj dhe Allahu do t’ju ndihmojë ta arrini objektivin, insha’Allah.”

Një du’a e posaçme që citohet nga Profeti i Bekuar (s.a.), thotë:

Dëshmoj se nuk ka hyjni përveç Allahut, të Vetmit pa partner, dhe se Muhammedi (s.a.) është shërbëtori e i dërguari i Tij. Dëshmoj se Xhenneti është hak dhe Xhehenemi është hak, se vakti po afron, pa asnjë dyshim, dhe se Allahu do t’i ngjallë ata që janë në varre. Dëshmoj gjithashtu se Allahu është Zoti im: nuk ka të dytë, as bir, as baba, dhe dëshmoj se Ai bën çfarë dëshiron e është i aftë për gjithçka dhe Ai është Bërësi i asaj që dëshiron. Ai poshtëron kë do dhe lartëson kë do, është Zotëruesi i gjithçkaje, Furnizues i robërve, Falësi, Mëshiruesi, i Gjithdijshmi, i Buti. Dëshmoj sërish dhe pa ndërprerje se Ti, o Zot, je pikërisht ashtu, e edhe më shumë, dhe se askush nuk mund ta përshkruajë madhësitinë Tënde. O Zot! Të përgjërohëm t’i

dërgosh bekime Muhammedit (s.a.) dhe Pasardhjes së Muhammedit, e të më udhëzosh pa më lënë të shmangem pasi që të më kësh udhëzuar, sepse Ti udhëzon atë që Ti do!

Vepra të Këshillueshme për Natën e 23-të të Muajit të Ramazanit

Të gjitha veprat e këshillueshme që janë përmendur më lart vlejné edhe për këtë natë dhe ato që janë rreshtuar si të mundshme për Lejletu'l-Kadrin. Në secilën nga këto net duhet marrë *ghusl* dy herë: një në fillim të natës e një në fund, siç transmetohet se ka porositur Imam Sadiku. Këshillohet gjithashtu të lexohet Surja Rum dhe Ankebutë, sepse Imam Sadiku citohet t'i ketë thënë Ebu Basirit se kushdo që e reciton Suren er-Rumë dhe Suren el-Ankebutë natën e njëzet e tretë të muajit të Ramazanit do të jetë patjetër mes banorëve të Xhenetit, duke shtuar: "...dhe nuk druham se Allahu do të ma njehë për mëkat që u dhashë një pozitë të tillë këtyre dy sureve." Po ashtu, rekomandohet recitimi i sures Duhanë.

Imam 'Aliu ka thënë: "Çdo gjë e ka një frut, dhe fruti i Kur'anit Kerim është Sureja el-Kadr. Çdo gjë e ka një thesar dhe thesari që largon varfërinë është Sureja el-Kadr. Çdo gjë e ka diçka përmes të cilës të arrihet, dhe mjeti i të skamurve është Sureja el-Kadr. Për çdo vështirësi ka lehtësim dhe lehtësimi i hallexhinjve është Sureja el-Kadr. Çdo e keqe e ka një mburojë, dhe mburoja e besimtarëve është Sureja el-Kadr. Për çdo gjë ka udhëzim dhe udhëzimi i të drejtëve është Sureja el-Kadr. Për çdo gjë ka shkëlqyeshmëri, dhe shkëlqyeshmëria e diturisë është Sureja el-Kadr. Për çdo gjë ka stoli dhe stolia e Kur'anit Kerim është Sureja el-Kadr. Ka një tendë për gjithçka dhe tenda e të përzotshmëve është Sureja el-Kadr. Çdo gjë e ka sihariqin e vet dhe sihariqi i të pafajshmit është Sureja Kadr. Ka argument (*huxhxhe*) për gjithçka dhe argumenti i Profetit (s) është Sureja el-Kadr, ndaj besoni në të!" Kur e pyetën se si të besohej në të, ai u përgjigj: "Ajo do të ndodhë në çdo vit dhe gjithçka e shpallur në të është e vërtetë."

Imami gjithashtu citohet të ketë thënë: "Kujtdo që e reciton Suren el-Kadr, Allahu Fuqiplotë do t'i shkruajë një vepër të mirë për çdo grimcë pluhuri ku ai është ulur për ta recituar." Ai gjithashtu citohet të ketë thënë për Suren el-Kadr se: "Ajo është shoqëruese e mirë për atë që kërkon të lajë borxhet, të vlerësojë besimin, të zgjasë jetën dhe të përmirësojë gjendjen. Ai që e lexon atë mjaft shpesh do ta takojë Allahun si *siddik* ose si *shhid*."

Në veprën *Misbah ul-Mutehaxxhid* citohet Muhammed ibn 'Isa, që transmeton nga Imamët se: "Gjatë natës së njëzet e tretë të muajit të bekuar të Ramazanit duhet përsëritur kjo du'a – ose në sexhde, ose në këmbë, ose ndenjor apo në ndonjë pozicion tjetër, madje edhe në cilindo muaj apo ditë tjetër, si dhe kur përballeni me kohë të vështira. Pasi madhërohet Allahu dhe i dërgohen bekime Pejgamberit dhe pasardhësve të tij, duhet thënë:

O Zot! Bëju ualiut Tënd Muhammed ibn el-Hasan
në këtë çast dhe gjatë gjithë natës e ditës
Mbrotës, Rojtar, Udhëheqës, Mbështetës, Udhëzues dhe Tregues,
gjersa ta lësh të banojë në tokën Tënde
dhe t'i dhurosh në të shijim të gjatë.

O Kontrolluesi i çështjeve,
O Ringjallësi i atyre që janë në varre,
Lejuesi i oqeanëve të qarkullojnë
dhe i hekurit që të zbutet për Davudin ('a),
të përgjërohem t'ia dërgosh bekimet e Tuaja Muhammedit
dhe pasardhjes (al) së Muhammedit!

Pastaj përmendni kërkesën tuaj, duke ngritur duart. Këtë mund ta përsërisni në sexhde, në ruku, në kijam dhe në natën e fundit të muajit të Ramazanit.”

Du'a për Natën e Njëzetetretë të Muajit

Du'aja e mëposhtme transmetohet nga Pejgamberi Fisnik (s.a.):

O i Lavdëruar, i Madhëruar, Zot i engjëjve dhe i Shpirtit,
i Lëvdëruar, i Lartësuar, Zot i melekëve dhe i 'Arshit
i Lavdëruar, i Madhëruar, Zot i qiejve dhe i tokës
i Lëvdëruar, i Lartësuar, Zot i oqeanëve dhe i maleve
i Lavdëruar, i Madhëruar, i lavduar nga peshqit në oqeanë, zvarranikët dhe
kafshët në kodra
i Lëvdëruar, i Madhëruar, i Lartësuar, Krijuesi i gjithçkaje me masë
i Lavdëruar, i Lavdëruar, i Lavdëruar, i Lavdëruar, i Lavdëruar
i Madhëruar, i Madhëruar, i Madhëruar, i Madhëruar, i Madhëruar!
Të përgjërohem ta bekosh Muhammedin dhe pasardhjen e Muhammedit
dhe të më falësh e mëshirosh, pase Ti je i Vetmi, Uniku.

Pastaj duhet thënë:

O Zot!
Të përgjërohem të më ndash (hise)
nga çdo mirësi që ke zbritur në këtë Natë
ose që do të dërgosh në të si më bujarja
dritë me të cilën Ti udhëzon
ose furnizim që Ti cakton
ose fatkeqësi që Ti largon
ose ligësi që Ti zbulon
dhe të shkruash për mua atë
që shkruan për robërit meritues të shpërblimeve Tuaja
dhe që meritojnë siguri duke të kënaqur Ty.
Ti tërheq dënimin
dhe jep pa masë
sepse Ti je Bujari!
Të përgjërohem ta bekosh Muhammedin dhe pasardhjen e Muhammedit
e të më trajtosh me mëshirë
O më i Mëshirshmi i mëshiruesve!

Pastaj duhet thënë:

Të përgjërohem si i skamuri pa fuqi
dhe të lutem si i varfri me përulësi
e të kërkoj si ai që Të është nënshtruar me hir
dhe e ka pranuar fajin me sytë e stërnjomur
si më i pafuqishmi që s'ka mjete të tjera
që të m'i falësh gjynahet e shkuara
e të më mbrosh nga të ardhshmet
të ma dhurosh haxhixin dhe 'umren këtë vit
që ta kryej pastërtisht për kënaqësinë Tënde
e të ma lejosh këtë përherë
dhe të mos më pengosh nga vizita e Shtëpisë Tënde
dhe e faltores së të Dërguarit Tënd Muhammedit
bekimet dhe paqja jote qofshin me të e të tijët.
Dhe të përgjërohem, o Zot
të mos më lësh në nevojë të krijesave të Tua
të xhinëve apo njerëzve
arabëve e joarabëve dhe
të çdo qenieje që ti sundon,
sepse Ti je Rruga e Drejtë
O Zot, dhuromë nga ç'vendos e urdhëron
mbi çështjet e përcaktuara në këtë Natë,
fatin që nuk mund të shmanget apo ndryshohet
që ta vizitohet Shtëpinë Tënde të shenjtë
me haxhilerët këtë vit
haxhixin e të cilëve e vlerëson
dhe përpjekjet e të cilëve falen
bashkë me mëkatet
dhe zgjatma jetën
rritma rrizkun
e dhuromë një djalë të denjë
sepse Ti bën çfarë dëshiron
dhe di gjithçka.

Ajo që duhet përsëritur në çdonjërin nga dhjetë netët e fundit

Një shënim në librin *el-Misbah* të Kaf'amiut përmban një du'a të transmetuar me autoritetin e Imam Sadikut. Ajo këshillohet të përsëritet në çdonjërin nga dhjetë netët e fundit të muajit. Autori tregon se Imami e kishte zakon të lutej kështu në çdo natë të kësaj pjese të muajit të Ramazanit:

O Zot,
Ti ke thënë në Librin Tënd të shpallur:
{muaji i Ramazanit është ai në të cilin u shpall Kur'ani
udhëzim për njerëzit dhe prova të qarta udhërrëfimi e dallimi}
dhe e ke madhëruar shenjtërinë e muajit të Ramazanit
me Kur'anin Fisnik që ke zbritur në të
duke ia caktuar Lejletu'l-Kadrin
për ta bërë më të mirë se njëmijë muaj.

O Zot,
Ti je më i ndërgjegjshëm se unë
dhe më i dijshtëm
për numrin e të devotshmëve të Tu
ndaj, të përgjërohëm me ata ëngjëj që ke pranë
me të dërguarit e Tu
evlijatë e Tu të drejtë
ta bekosh Muhammedin dhe pasardhjen e Muhammedit
që të më lirosh nga zjarri
të ma lejosh hyrjen në Xhennet
dhe të jesh i Butë me mua,
të më falësh
të ma pranosh përpjekjen për të T'u afruar
të m'i përgjigjesh lutjes
dhe të më japësh siguri në ditën,
kur të gjithë do të tmerrohen
nga tmerri i përgatitur në Ditën e Gjykimit!

O Zot,
kërkoj strehë te Lavdia dhe Prestigji Yt
që të mos i lësh ditët dhe netët e Ramazanit të kalojnë
pa m'i falur gjynahet për të cilat ke vendosur të pendohem
O Zot, o Zot, o Zot!
Të lutem Ty, veç të Cilit nuk ka zot tjetër
që të kënaqesh me mua në këtë muaj
dhe të jesh edhe më i kënaqur
sesa mund të kesh qenë më parë!
Ndaj, ji i kënaqur me mua, o Zot,
sepse ti je Më i Mëshirshmi i mëshiruesve
O i Vetmi, i Vetmjaftueshmi, që nuk ke lindur e as je lindur
e që nuk ka asnjë si Ti.

pastaj duhet përsëritur të paktën tri herë:

O Ai që e bëri hekurin të butë për Davudin ('a)
O Ai që ia largoi pikëllimin dhe agoninë Jakubit ('a)
O Ai që ia largoi trishtimin Jusufit ('a)
Të përgjëroj ta bekosh Muhammedin dhe Familjen e Muhammedit
pse Ti je i aftë për këtë
e mos më dëno me dënimin që meritoj!